



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:048762
Datë: 29.11.2024
Numri i dokumentit: 06526057

A.nr.584 /2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni dhe me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Nikolla, në konfliktin administrativ të paditëses, F.SH. nga P..., të cilën e përfaqëson avokati ... nga P..., me adresë ne rrugën “...” Nr.... kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK) me seli në Prishtinë, me bazë juridike: “*anulim vendimi*”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palës paditëse dhe palës së paditur, si dhe në mungesë të palës së interesit, me datë.14.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET kërkesëpapia e paditëses F.SH. nga P..., me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e paditëses dhe të anulohet akti administrativ (njoftimi) i të paditurit KPM SHCK dhe të detyrohet i padituri që paditëses t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar në rastin e mos pagesës retroaktive konform pozitës dhe koeficientin për periudhën prej 01.01.2006 deri në aktgjykimin e plotfuqishëm, në emër të kompensimit të paguajë 10 % Trustin Pensional për periudhën prej 01.01.2006 deri në aktgjykimin e formës së prerë, si e pa bazuar.

II.Ky aktgjykim zëvendëson aktin e organit kompetent dhe ka karakter të detyrueshëm.

III.Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së në prani të përfaqësuesit të palës paditëse avokatit ... me autorizim dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur ... me autorizim, si dhe në prani të ekspertes financiare ... personalisht, si dhe në mungesë të palës së interesuar, respektivisht përfaqësueses së saj Avokaturës Shtetërore, e ftuar në mënyrë të rregullt (Provë: fletë kthesa e datës 09.10.2024).

Paditësja ... me padinë e datës 14.03.2022 dhe në seancën mbi shqyrtimin kryesor përmes përfaqësuesit të saj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e paditëses dhe të anulohet akti administrativ (njoftimi) i të paditurit KPMSHCK dhe të detyrohet i padituri që paditëses t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në rastin e mospagesës retroaktive konform pozitës dhe koeficientin për periudhën prej 01.01.2006 deri në aktgjykimin e plotfuqishëm, në emër të kompensimit të paguajë 10 % Trustin Pensional për periudhën prej 01.01.2006 deri në aktgjykimin e formës së prerë, sii dhe të detyrohet i padituri ti paguajë shpenzimet e procedurës sipas ligjit dhe kamatën ligjore prej 8% nga viti 01.01.2006 deri në aktgjykimin e plotfuqishëm. I njëjti në seancë ka deklaruar se e mbështet në tërësi ekspertizën financiare. Kërkon nga gjykata që ta obligojë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve që në llogarinë e paditëses nga organi punëdhënës t'ia bëjë pagesën në shumë prej 25,509.25 €. Gjithashtu ka kërkuar që gjykata të vendosë çështjen në mënyre meritore, pasi që e paditura në mënyrë të një pas njëshme nuk ka vendosur për çështjen kontestuese edhe pas marrjes së aktgjykimit nga ana e gjykatës.

Gjykata në bazë të nenit 68 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në seancën mbi shqyrtimin përgatitor të datës 23.04.2024 ka kërkuar nga i padituri, në këtë rast nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që ti ofrojë gjykatës përgjigje në padi së bashku me të gjitha provat që janë objekt shqyrtimi i kësaj lënde, mirëpo i njëjti, edhe pse procesverbalin e ka pranuar me datën 29.04.2024, asnjëherë nuk ka sjellë njoftimin- përgjigje në padi.

I padituri KPMSHCK në seancën mbi shqyrtimin kryesor ka deklaruar që, në parashtrimin e ankesës së ankueses Këshilli ka qenë jo funksional, prandaj mbi bazën e kësaj është njoftuar për shkak se nuk mund të vendosë lidhur me ankesën e saj. Thekson se, përkundër faktit se gjykata me aktgjykim ka obliguar Këshillin prapë ta shqyrtoi ankesën e ankueses, këtu paditëses, Këshilli sërish në mungesë të kuorumit për të vendosur lidhur me ankesën e ka njoftuar paditësen, përmes njoftimit se nuk mund të vendosë lidhur me ankesën. Prandaj mbi bazën e kësaj, gjykatës i ka propozuar që të vendosë në pajtim me ligjet në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 14.10.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Ekspertiza Plotësuese e datës 02.10.2024, Ekspertiza Financiare e datës 15.08.2024, emaili i datës 25.06.24, 22.06.24, 30.06.24, 01.08.24, 02.08.24, trusti i datës 20.06.24, Aktgjykimi i datës 06.07.21 me numër A.nr.1601/20, Kërkesa për përsëritje të procedurës e datës 14.02.22, ankesa e datës 22.11.19, Vendimi i datës 14.01.20, Njoftimi i datës 10.07.20, akt përcjellësi i datës 21.07.20, Kërkesa e datës 16.07.20, akt emërimi i datës 06.06.2012, Vendimi për transfer i datës 10.09.2010, Kartela e nëpunësit e datës 21.07.20, emaili i datës 19.11.21, Ankesa e datës 10.07.20, Kërkesa për korrigjim të koficientit e datës 23.08.2018, Kërkesa e datës 04.06.2012, Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës e datës 20.12.19, Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i datës 22.12.17 dhe datës 25.12.15, dt.13.12.14, dt.06.12.11,

dt.08.12.10, Plani i punës i datës 30.06.2011, Akt emërimi i datës 01.01.12, Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 14.02.2011, Kontrata e datës 14.02.2011 dhe datës 20.10.2010, Vendimi për transfer i datës 10.09.2011, Kontrata e punës e datës 24.01.2007, Kontrata e punës e datës 11.01.2006, Formulari i regjistrimit të ankesës i datës 10.07.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e padisë / kërkesës së kërkueses, ... sipas nenit 68 paragrafi 1 të LKA-së i cili përcaktona se, nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë në bazë të paragrafit 4. të nenit 46 të këtij ligji, pala mund të kërkojë, me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë. Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda shtatë (7) ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin. 2. Në bazë të kërkesës së tillë, gjykata do të kërkojë nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat akti administrativ nuk është nxjerrë. Organi kompetent ka për detyrë ta japë këtë njoftim menjëherë, jo më vonë se brenda shtatë (7) ditësh. Nëse nuk e bën këtë, apo nëse njoftimi i dhënë, sipas mendimit të gjykatës, nuk e arsyeton moszbatimin e aktgjykimit të gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendimin, i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent. Këtë vendim gjykata do t'ia dërgojë organit kompetent për ekzekutim dhe për këtë gjë njëkohësisht do ta njoftojë organin që ushtron mbikëqyrjen. Organi kompetent për ekzekutim ka për detyrë që ta ekzekutojë vendimin e tillë.

Gjykata në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

I padituri Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 16.08.2021 ka dhënë njoftimin lidhur me ankesën me numër A.nr.185/2020 të datës 10.07.2020, në të cilën ka theksuar se, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur me datë 30.06.2021 ka shkarkuar pesë anëtarë, ku në këtë rast Këshilli ka mbetur pa anëtarë, e kjo e bën të pamundur që Këshilli të vendosë për ankesën, për arsye se ankesat i shqyrton Kolegji prej tre (3) anëtarëve.

Paditësja me padinë e datës 14.03.2022, i pakënaqur me aktin- njoftimin e të paditurës, dhe e cila padi ishte aprovuar me aktgjykimin A.nr.1601/2020 te datës 06.07.2021, me të cilin është anuluar akti administrativ (njoftimi) i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) Nr.ref.A.nr.185/2020 i datës 20.08.2020 dhe detyrohet e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh me vendim të vendosë lidhur me ankesën e paditësit të datës 10.07.2020 dhe të njëjtin t'ia dorëzojë palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Kështu duke qenë se nuk është nxjerr akti i ri administrativ dhe e paditura nuk ka njoftuar gjykatën lidhur me shkaqet e mos nxjerrjes së tij, gjykata ka nxjerr këtë vendim i cili e zëvendëson aktin e organit në këtë rast të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gjykata, në rolin e organit administrativ të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës me numër A.nr.1601/2020, u kujdes për të vlerësuar lidhur me ankesën e paditëses, e cila është parashtruar nga ana e saj pranë këtij të fundit me të cilin me Aktin-Njoftimin kontestues, nuk ka vendosur për çështjen.

Kështu, gjykata në vlerësim të çështjes kontestuese iu është referuar Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenit 16 paragrafi 3, i cili përcakton se: *“3. Në emër të Këshillit, ankesat i shqyrton dhe i vendos Kolegji i përbërë nga tre (3) anëtarë, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit”*. Andaj, i padituri nuk ka mundur të vendosë për ankesën e paditëses për shkak të mungesës së anëtarëve.

Gjithashtu, referuar periudhës kontestuese lidhur me kompensimin material nga viti 01.01.2006, nga koeficienti 6.5 në 8, gjykata kishte parasysh nenin 130.1 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative ku përcaktohet se: *“Afati kohor për ankimin administrativ 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a)ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b)akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi. 130.2. Në rastin e mosveprimit të administratës (mos nxjerrjes së aktit dhe heshtjes së plotë),ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ”*.

Po ashtu gjykata kishte parasysh edhe nenin 127 i te njetit ligje i përcakton se, *ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Me tutje neni 128 Adresimi i ankesës përcakton se, *1. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, një ankesë kundër një akti administrativ mund t'i drejtohet organit publik që ka nxjerrë apo ka kompetencë të nxjerrë aktin (në tekstin në vijim: organi kompetent), apo organit publik mbikëqyrës të organit kompetent, apo*

një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj (në vijim të dy këta të fundit: “organi epror”). Nëse ankesa i është drejtuar organit epror, ai ia përcjell, pa vonesë, organit kompetent. 2. Ankesa ndaj heshtjes administrative mund t’i drejtohet drejtpërdrejt organit epror. Nëse ankesa i është drejtuar organit kompetent, ai ia përcjell, pa vonesë, organit epror, së bashku me dosjen e çështjes dhe një raport të shkruar për arsyet e heshtjes.

Andaj në vështrim të dispozitave të lartcekura sa i përket pjesës së kërkesës së paditëses që ti bëhet kompensimi material nga viti 01.01.2006, nga koeficienti 6.5 në 8, gjykata konstaton se, kjo ka të bëjë me një afat të gjatë kohor, ku nuk janë shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative. Përveç kësaj, paditësja që nga viti 2006 nuk ka shfrytëzuar heshtjen administrative të MPMS-së, për të ju drejtuar instancave tjera që ia garanton ligji- dispozitat e lartcekura.

Për të llogaritur lartësinë e kompensimit të të ardhurave për paditësen që nga data 01.01.2006, gjykata me propozimin e përfaqësuesit të paditëses në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 28.05.2024, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ, ku si ekspert financiar është caktuar Ekspertja gjyqësore - financiare e caktuar nga gjykata në ekspertizën financiare, respektivisht plotësimin e Ekspertizës të datës 02.10.2024 ka dhënë mendimin profesional të shumës totale të detyrimeve në emër të diferencës së pagave, është 16.638.58 Euro (diferenca e pagave bruto) dhe 823.34 Euro (kontributi pensional nga mjetet e punëdhënësit) që në total bëjnë 17.461.92 Euro, si dhe kamata e vonesës që i takon paditëses nga diferenca e koeficientit të pagave (koeficienti 6.8-8), është në shumën prej 8.047.33 Euro.

Gjykata këtë ekspertizë financiare e mori në tërësi si të besueshme, për arsye se, e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat e caktuara nga gjykata dhe se as palët ndërgjyqëse nuk patën vërejtje në kalkulimet e plotësimit të ekspertizës, mirëpo kjo ekspertizë nuk ishte relevante në këtë rast, sepse gjykata vendosi ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

Për arsyet e cekura më lartë, gjendja faktike nuk ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative në bazë të fakteve të vërtetuara.

Gjykata iu referua nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet ku përcaktohet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Me nenin 319.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta” Bazuar në dispozitat e lartcekura,

gjkata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit, nënkupton një detyrim për palët. Kjo lidhet me detyrimin për respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjkata shqyrtoi edhe pretendimet e paditëses, por të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje juridike, dhe se paditësja nuk ka ofruar prova të reja dhe po ashtu nuk ka pasur propozime për prova të reja me të cilat do të dëshmonte se të njëjtës i takon kompensimi për periudhën nga data 01.01.2006 e deri në aktgjykimin e plotfuqishëm. Mbi këto arsye kërkesëpadinë/kërkesën sipas nenit 68 të LKA-së të paditëses nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në kuptim të nenit 64 të LKA-së.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.584/2022 data 14.10.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Donjeta Nikolla

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.